



Të folurit me fëmijët rreth

RREGULLIMIT TË MJEDISIT





RREGULLIMI I MJEDISIT

Ju jeni kënaqur duke luajtur me birin tuaj 1-vjeçar Markun. Së bashku keni ndërtuar shtëpi të mëdha dhe kështjella me blloqe lodrash. Pastaj keni shtyrë makinat lodra rreth këtyre ndërtesave, duke shkaktuar shembjen e kështjellave. Marku po ashtu ka marrë libra të ndryshëm nga rafti. Tani, blloqet e ndërtimit, librat, makinat lodra dhe shumë gjëra të tjera janë përhapur në gjithë dyshemenë dhe mobiljet e dhomës. Kur vjen koha për të pastruar, ju doni që fëmija juaj ta rregullojë dhomën së bashku me ju. Por Marku nuk tregon interes; ai është i lodhur, i zemëruar, i uritur dhe fillon të hedhë lodra përreth.

A i njihni situatat e tilla? Kur ndodhin ato? Si reagoni ju?

Ne do të donim t'ju japim disa sugjerime për t'u marrë me këto situata. Por së pari, ja disa pyetje që mund t'i merrni në konsideratë/diskutoni lidhur me reagimin tuaj fillestar në një situatë të tillë.

Analizë



Si do të ndërveproja në situata të tilla?

Si do të reagonte Marku?

Si do të merresha me reagimin e Markut?

A do të çonte kjo situatë në konflikt? Nëse po, si do ta zgjidhja atë? A do të kishte zgjidhje?

Si do të përfundonte situata me Markun?

Këshilla



Këtu do të gjeni disa sugjerime për zgjidhje të mundshme të situatës së përshkruar më lart. Nëse keni mundësi, ju lutemi diskutoni me miqtë tuaj ose bashkëshortin a bashkëshorten tuaj. Shkëmbeni përvojat tuaja përmes një diskutimi të hapur.

A ka gjëra që dëshironi t'i ndryshoni? Ne shpresojmë t'ju inkurajojmë që t'i provoni idetë dhe veprimet që besoni se mund të ndihmojnë në zgjidhjen e një problemi me një fëmijë të lodhur që nuk është i gatshëm të pastrojë rrëmujën.

Nëse fëmijët mësojnë të marrin përgjegjësinë në mënyrën e tyre të mundshme, ju i mbështetni ata për t'u bërë anëtarë të përgjegjshëm të shoqërisë, duke marrë pjesë në të jetuarit e demokracisë. Për më shumë informata, ju lutemi vizitoni ueb faqen tonë: https://www.living-democracy.com/sq/suggestions/?key_concept=responsibility

- Shikoni se si flisni me fëmijën tuaj: nëse shpesh përdorni urdhra, komanda dhe qortime, kjo mund ta pengojë përvetësimin e gjuhës. Për më tepër, kjo është lënduese për fëmijën dhe mund ta pengojë atë që të mësojë çfarëdo gjëje. Mundohuni të shmangni komandat negative si: “Vendosi gjërat e tua tutje!” “Pastroje dhomën!” Nëse dëshironi të lexoni më shumë rreth komunikimit që nuk është i favorshëm për jetën demokratike dhe dëshironi të rishqyrtoni stilin tuaj të komunikimit në lidhje me mesazhet destruktive, ju lutem vazhdoni të lexoni në [faqen 5](#).
- Mundohuni t'u siguron fëmijëve gjithmonë mundësi të shumta dhe t'i pyetni për opinionet e tyre. Ju mund ta bëni këtë me pyetje të tilla si: “Çfarë do të bëjmë me të gjitha këto lodra kur të mbarojmë së luajturi?” Fëmijët duan të marrin komente pozitive. Ju mund ta shprehni këtë me komplimente dhe reagime pozitive kur një fëmijë ofron veprime ose përgjigje konstruktive: “Po, ke të drejtë, i sistemojmë lodrat, bravo!” Ose “po, unë e di, je i lodhur, le ta bëjmë shpejt së bashku, dhe pastaj do të hamë darkë” ose “po, unë po e shoh se je i zemëruar, a do që ta bësh atë nesër?”
- Veproni si model i mirë: Tregoni si të vendosen të gjithë librat në raft, bllloqet e ndërtimit në një kuti dhe makinat lodra në një tjetër. Ju gjithashtu duhet të mbani rregull në dokumentet tuaja, librat, pajisjet e kuzhinës apo veglat. Fëmija juaj do të vërejë dhe do të mësojë “Unë mund t'i gjej gjërat e mia më lehtë dhe është më kënaqësi t'i përdor ato, nëse mbaj rregull!”
- Ftoni fëmijët t'i shfaqin mendimet e tyre dhe dëgjojeni ata. Në këtë mënyrë ju stimuloni zgjerimin e fjalorit të tyre dhe rrjetin neutral në trurin e tyre.

Mesazhet destruktive:

Mesazhet dhe deklaratat të cilat provokojnë ndjenja dhe reagime negative të fëmijët tuaj quhen mesazhe destruktive. Ju nuk i respektoni dhe toleroni ndjenjat dhe mendimet e fëmijëve tuaj kur ndërveproni në këtë mënyrë. Respekti dhe toleranca janë bazë për veprim demokratik dhe mesazhet destruktive nuk i përcjellin ato të fëmijët tuaj. Fëmijët tuaj mund të përgjigjen me përgjigje të shkurtra, duke u mbrojtur, duke u ndier të keqkuptuar dhe të degraduar. Këto lloj mesazhesh çojnë në konflikte dhe nganjëherë ndalojnë procesin e komunikimit krejtësisht.

Mesazhet destruktive i lënë pas fëmijët. Ata nuk mund ta zhvillojnë potencialin e tyre të plotë kur dëgjojnë vetëm mesazhe negative dhe degraduese. Kjo gjithashtu i parandalon ata të zhvillojnë personalitete të forta, të cilat përbëjnë bazën e shoqërive demokratike.

Për të përmirësuar aftësitë tuaja të komunikimit dhe për të krijuar një stil më demokratik, duhet së pari të vlerësoni mënyrën e tanishme të komunikimit. Dëshironi ta bëni këtë? Filloni ushtrimet tuaja në faqen tjetër.

Ushtrim:

Në vijim janë paraqitur shembuj të ndryshëm të mesazheve destruktive. Vëzhgoni sjelljen tuaj komunikuese në baza ditore, për një javë. Çdo herë që përdorni një nga shprehjet e mëposhtme kur flisni me fëmijën tuaj, bëni një vijë prapa kësaj fjalie.

Komandimi, urdhërimi

- Ti duhet të...
- Eja, bëhu gati...
- Thuaj tungjatjeta...
- Sillu mirë...

Sharja, paralajmërimi, kërcënimi

- Ti gjithmonë...
- Ti kurrë nuk...
- Nëse nuk..., atëherë...
- Kur, më në fund, do...
- Sa herë duhet të ta them që...

Moralizimi

- Ne do të ishim kaq shumë krenarë për ty, por tani jemi të zhgënjyer, sepse ti nuk...
- Mami është vërtetë e trishtuar sepse je aq i keq.
- Ka mijëra fëmijë të uritur të cilët dëshirojnë ta hanë këtë.
- Një herë gënjeshtar, gjithmonë gënjeshtar.

Dhënia e këshillave dhe krahasimi

- Po të isha ti, unë do të ...
- Prindërit e fëmijëve të tjerë do të ...
- Motra jote gjithmonë e rregullon dhomën e saj.
- Të gjithë pajtohen me këtë. Por ti ...

“Të folurit me fëmijët rreth rregullimit të mjedisit” është bazuar në referencat më poshtë:

¹ Heueck-Mauss, Doris. 2016. *So rede ich richtig mit meinem Kind: Wie Worte wirken: Konflikte fair lösen: Stressfreier erziehen*. Hannover: Humboldt, 74ff.

Nolan, Virginia. 2016. «Die Macht der Sprache.» *Das Schweizer Elternmagazin Fritz und Fränzi*, Oktober, 58-64.